



REPUBLIKA E SHQIPERISË



**UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK**

Nr. 2951 / Prot.

Tiranë, më 22 / 12 / 2022

VENDIM

Nr. 27, datë 22.12.2022

PËR

**MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT
TË CIKLIT TË TRETË “DOKTORATË” NË INXHINIERI MEKANIKE, ME NËNFUSHË
INXHINIERI MEKANIKE DHE NËNFUSHË INXHINIERI E MATERIALEVE, NË
FAKULTETIN E INXHINIERISË MEKANIKE, NË UPT**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë" i ndryshuar, Udhëzimit të MAS Nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë" i ndryshuar, kërkesën e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe Rregulloren e Studimeve të Doktoratës të UPT-së, Senati Akademik në mbledhjen e datës 22.12.2022,

VENDOSI:

Miratimin e propozimit për riorganizimin e programit të studimit të ciklit të tretë "Doktoratë" në Inxhinieri Mekanike, me nënfushë Inxhinieri Mekanike dhe nënfushë Inxhinieri e Materialeve, dhe miratimin e katër projekteve kërkimore-shkencore në "Studim mbi vlerësimin numerik të emetimeve ndotëse nga motorët me diegie të brendëshme. Rast studimi: Situata në Shqipëri, vlerësime dhe rekomandime për arritjen e targeteve të vitit 2030 në përputhje me-Planin Kombëtar për Energjinë dhe Ndryshimet Klimatike 2021-2030", "Studimi i vetive elektrike të fibrave tekstile dhe ndikimi i tyre në proceset e përpunimit", "Modelimi dhe optimizimi i proceseve të prodhimit dhe zinxhirit të furnizimit në Shqipëri" dhe "Optimizimi i proceseve industriale të përpunimit të disa lidhjeve për deformim të aluminit dhe studimi i prodhimit eksperimental, formësimit dhe karakterizimit të kompoziteve nanogrimcore Al-Qeramikë e avancuar", në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Andrea Maliqari

